



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2023:195592  
Datë: 01.03.2024  
Numri i dokumentit: 05400347

PPP.nr.500/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtorin profesional Festim Zeqiri, në çështjen juridike përmbareme të kreditorit Ipko Telecommunications L.L.C., me seli në Prishtinë, kundër debitorit F.O nga Prishtina, rruga “Holger Petersen”, B7/K3, nr.11 (Vëllezërit Asllani), lidhur me çështjen përmbareme për pagim borxhi, në vlerën prej 335.01 €, duke vendosur lidhur me prapësimin e ushtruar nga debitori kundër Urdhrit për lejimin e përmbaremit numër P.nr.482/23, të datës 14.08.2023, të lejuar nga Zyra Përmbareme - Përmbareusi Privat Rrezarta Metaj me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 01.03.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. **HIDHET POSHTË** si pasafatshëm prapësimi i ushtruar nga debitori F.O nga Prishtina, i datës 05.09.2023 kundër urdhrit përmbaremit P.nr.482/23, i datës 14.08.2023, i lejuar nga Përmbareusi Privat Rrezarta Metaj në Prishtinë.
- II. Mbetet në fuqi urdhëri përmbaremit P.nr.482/23, i datës 14.08.2023 i lejuar nga Përmbareusi Privat Rrezarta Metaj në Prishtinë, deri në përmbushjen përfundimtare të detyrimit.

**A r s y e t i m**

Zyra Përmbareme - Përmbareusi Privat Rrezarta Metaj, në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka caktuar përmbaremin kundër debitorit F.O, ashtu që është detyruar debitori që në emër të përmbushjes së obligimeve nga faturat brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrit t’ia paguan kreditorit shumën prej 335.01 Euro, si dhe kamatë vonesën prej 8% në vit, duke filluar nga data e skadimit të pagesës për secilën faturë e deri në pagesën definitive të borxhit, si dhe shpenzimet e procedurës përmbareme. Po ashtu ka përcaktuar se të gjitha detyrimet do të realizohen përmes zbatimit të përmbaremit duke bërë

bllokimin e llogarive bankare të debitorit dhe bartjen e tyre në llogarinë bankare të përmbarueses private. Nëse debitori nuk posedon mjete monetare në llogaritë e tij bankare, atëherë përmbaruesi privat do të zbatoj përmbarimin përmes sekuestrimit të sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Kundër urdhërit për lejim të përmbarimit, debitori me datë 05.09.2023 ka paraqitur prapësim duke i shprehur pretendimet si në të njëjtin.

Përgjigje në prapësim lidhur me këtë çështje përmbarimore ka paraqitur edhe kreditorja me datën 08.09.2023.

Pas pranimit të lëndës dhe pas analizimit të shkresave të lëndës, gjykata gjeti se debitori ka lëshuar afatin ligjor për paraqitje të prapësimit, andaj gjykata pa u lëshuar në meritat e prapësimit vendosi që të njëjtin ta hedhë poshtë si të pasafatshëm.

Nga shkresat e lëndës respektivisht flete dërgesa e Postës së Kosovës, rezulton se debitori me datë 28.08.2023 e ka pranuar urdhërin për lejimin e përmbarimit P.nr.482/23, ndërsa në bazë të vulës së protokolluar nga përmbaruesi privat nr.1995/23 rezulton se pranë zyrës së përmbaruesit privat debitori prapësimin e ka paraqitur me datë 05.09.2023.

Me nenin 70 të LPP-së, është përcaktuar afati kohor për paraqitjen e prapësimit dhe atë: *“Prapësimi duhet t’i paraqitet organit përmbarues brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbarues ose urdhrit përmbarues.”*. Ndërsa me nenin 17 lidhur me nenin 126 par.1 të LPK-së, parashihet se: *“Afatet llogariten me ditë, muaj dhe vite”*, ndërsa paragrafi 2 i këtij neni parasheh se: *“Në qofte se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.”*.

Pra duke pasur parasysh se debitori, propozimin për përmbarim e ka pranuar me datë 28.08.2023, në bazë të dispozitave ligjore të lartcekura, afati për paraqitje të prapësimit ka filluar të rrjedhë nga dita e nesërme pra prej datës 29.08.2023.

Në bazë të shkresave të lëndës gjykata ka vërtetuar faktin se debitori prapësimin e ka paraqitur me datë 05.09.2023, kjo rrethanë vërtetohet nga vula e protokollit të përmbaruesit nr.1995/23. Nën këto rrethana gjykata gjeti se prej datës 29.08.2023 kur ka filluar të rrjedhë afati për paraqitjen e prapësimit e deri me datën 05.09.2023 kur është paraqitur prapësimi kanë kaluar 7 ditë, respektivisht prapësimi është paraqitur në ditën e 8 (tetë). Andaj meqenëse gjykata gjeti se prapësimi i debitorit është paraqitur jashtë afatit ligjor, nuk u lëshua fare në meritat dhe themelësinë e prapësimit dhe në bazë të nenit 73 paragrafi 3 i LPP-së, ku parashihet se *me vendim prapësimi mund të pranohet, refuzohet ose hidhet poshtë si i pa afatshëm, si jo komplet dhe i palejuar*, vendosi që prapësimin e debitorit ta hedhë poshtë si të paafatshëm dhe urdhëri përmbarimor të mbetet në fuqi deri në përmbarim të përfundimtar të detyrimit.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil  
PPP.nr.500/23, dt.01.03.2024

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.